REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 51/17
Datë/Datum. 04.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. Nr. 51/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej: z. Tefik Sylejmani - Kryetar, z. Nuhi Paqarizi – Referues dhe Blerim Dina –anëtar,duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "Limit L&B" - Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Shenjëzimi horizontal e vertikal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit", me nr. të Prokurimit:622/16/086/511 të iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prizrenit , më: 31.03.2017, mori këtë :

V E N D I M

I. **Aprovohet**, pjesërisht si e bazuar ankesa e OE ankues "Limit L&B" - Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Shenjëzimi horizontal e vertikal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit", me nr. të Prokurimit:622/16/086/511 të iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prizrenit .

II.Shfuqizohet vendimi i panelit shqyrtues nr.435/16 i dt.17.01.2017, konform nenit 100:101 dhe 102 të ligjit për Procedur Administrative nr.02/L-28, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Shenjëzimi horizontal e vertikal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit", me nr. të Prokurimit:622/16/086/511.

III.Anulohet vendimi i autoritetit kontraktues – Komuna e Prizrenit për dhënie te kontratës, lidhur me procedurën e prokurimit me titull "Shenjëzimi horizontal e vertikal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit", me nr. të Prokurimit:622/16/086/511 dhe lënda kthehet në ritendrim.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi detyron panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-ës të ndërmarr masa ndaj autoritetit kontraktues,që nuk respekton vendimin e panelit shqyrtues të parapar me këtë ligj

V. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Limit&B" - Prishtinë janë pjesërisht të qëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së, ju kthehet sigurimi i ankesës.OE në

afat prej 60 ditësh janë të obliguar të parashtrojnë kërkesë për tërheqjen e mjeteve në të kundërtën këto mjete barten në buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues Komuna e Prizrenit ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë me datë 17.08.2016 për aktivitetin e prokurimit"Shenjëzimi horizontal e vertikal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit", me nr. të Prokurimit:622/16/086/511,lloji i procedurë së aplikuar e hapur,kontratë pune,afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë dt.02.09.2016 dhe po të njëjtën ditë është bërë hapja e ofertave. OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit kanë qenë gjithësejt 7(shtatë).

Kriter për dhënien e kontratës AK është përcaktuar për tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Autoriteti kontraktues formon komisionin vlerësues në përbërje prej tre anëtarësh me qëllim të ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve dhe për kontratë rekomandojnë OE"Sinjalizimi"nga Suhareka dhe atë pas kërkesës për ri-shqyrtim pran autoritetit kontraktues.

OE ankues me datë 21.02.2017 parashtron ankesë në OSHP lidhur me pretendimet ankimore, të parapara sipas LPP-së.

OSHP me 28.02.2017 autorizon ekspertët z.Basha dhe z.Dervishi, të cilët përgatitin raportin e ekspertizës dhe me 02.03.2017 ia dorëzojnë raportin panelit të OSHP-së ku me nga një kopje njoftohen edhe palët në procedurë. OE ankues me datë 03.03.2017 njofton OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertizës. Ndërsa AK janë pajtuar me raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues në seancën dëgjimore ku të pranishëm ishin përfaqësuesi i OE ankues,përfaqësuesi i AK si dhe eksperti shqyrtues u bë shqyrtimi i shkresave të lëndës si:autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues si dhe bëri dëgjimin e palëve ku në fillim fjala iu dha përfaqësuesit të OE ankues "Limit" z.Asllani i cili deklaroi: "Ne jemi ankuar në vendimin e dhënë "Snjalizimi", AK neve na thotë se jemi shpall të papërgjegjshëm, mirëpo këto janë dy lëndë të ndryshme.

Ne kemi plotësuar njëjtat kritere si OE i rekomanduar. Ekspertiza thotë se formulari "C" është i nënshkruar. Ne deklarojmë se aj formular as nuk ka vulë, as nuk ka nënshkrim, as poshtë as lartë. Kontratat që ka kërkuar AK janë vitet 2013-2014-2015. OE i rekomanduar për kontratë ka përfshirë një kontratë të datës 15.03.2016 në vlerë 439.000€, dhe dy kontrata i paraqet rrejshëm kinse i ka me MI, e në realitet janë kontrata me kompaninë kamion, të vëllait të vet. Janë dy vëllezër që nënshkruajnë çfarëdo dokumenti njërit tjetrit. ZMAS ka dokumente Sllovenishte nuk ka specifikim – listë pune, nuk ka referenca është shoqatë automobilistike Sllovene. Zmas nuk ka asnjë listë për punët të kryera për vitet 2013-20147-2015 ashtu siç janë kërkuar nga AK. Nuk ka referenca dhe nuk ka asnjë dokument të përkthyer në gjuhë shqipe apo angleze e gjitha është sllovenisht, ndërsa me ligj tek ne është parashikuar se në çfarë gjuhe mund të ofrohen dokumentet.

AK ka kërkuar listat dhe librezat e automjeteve, makina sinjalizimit është mjet që nuk regjistrohet dhe duhet bartur me mjet tjetër transportues, deri në vend punishte, dhe OE i rekomandua gjitha automjetet i ka me afat të skaduar 5 deri 6 muaj. Qarkullimin bankarë eksperti ja merr të vitit 2016,

ndërsa nga data 01.01.2013 deri me 31.12.2015 i ka 11,432.92€. Kurse në NLB i ka 198,511.07€. Gjithsej janë 209,931.39 €. ZMAS nuk ka dokumentacionin valdi nuk është i përkthyer , dh paraqet dokumentacion për një vit. Eksperti ja pranon qarkullimin prej 01.01.2016 deri me 31.08.2016. Në dosje të tenderit AK kërkon "kontratën ose marrëveshje me menaxherin e projektit, ose kontratë për bashkëpunim", kjo nuk është në dosje dhe nuk ka dëshminë për përvoj. Gjatësia tabelës me udhëzim administrativ është 25cm, ndërsa OE ka ofruar 24.7. Udhëzimi neni 7 pika 3 thotë mbishkrimi përbëhet nga shkronja të mëdha me ngjyrë të bardhë dhe sfondi blu. OE i rekomanduar për kontratë Sfondin e ka të bardhë, ndërsa mbi folinë transparente është e ngjyrosur me të kaltër. Neni 8.1 thotë "lloji i shkrimit është Kalibri. Shkronjat janë të printuara me Relief me lartësi 1mm". Fonti Kalibri është kërkuar 7cm, mirëpo kur vendoset thyesa (/) tek Rr../, shkronja automatikisht zvogëlohet ne 6 apo 5.2 cm. Ndërsa te emërtimi i rrugës është 7 cm dhe këtu nuk luan asgjë pasi këtu nuk ka thyes. Eksperti apo AK kurrë nuk ka matur mostra e kompanive, pse pyes këtë, është se mekanizimi jonë ka pas edhe këtë shtojcë, në zyre të AK-së është hjek kjo pjesë (shtojcë)".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-KK Prizren z.Osmankaj i cili deklaroj: "Fillimisht ankesa e OE ankues nuk është dashtë t ëpanohet fare nga OSHP mbështetur në nenin 111 të LPP-së ngase OE ankues në këtë fazë ka qenë palë pa interes për këtë proces të prokurimit. Me një vendim t ë OSHP ky OE është shpall i papërgjegjshëm. Arsyet janë të elaboruara për papërgjegjshmërinë e tij, një ndër arsyet ka qenë edhe një marrëveshje bashkëpunimi me një OE të Serbisë, e cila ka qenë fotokopje. Në kërkesën për rishqyrtim të vendimit që ka parashtruar OE "LIMIT", ja ka bashkangjitur marrëveshjen origjinale tani, e nënshkruar nga dy palët në origjinal, ku pretendon se kjo është marrëveshja që është ofruar në dosjen e tenderit. Në krahasimet që kemi bërë mes këtyre dy dokumenteve kemi vërejt mbi 10 elemente që dallojën këto dy marrëveshje. Andaj kemi kërkuar prej OSHP-së me shkresë dhe me dokumente të bashkangjitura shkresës që ndaj këtij OE të merren masa për falsifikim dokumenti sipas nenit 92 të LPP. Ne kemi dërguar për verifikim vërtetësinë e atyre dokumenteve. Dokumentet nuk kanë qenë të njëjta, ai i ofruar në dosje ka qenë diçka tjetër, ndërsa dokumenti që OE pretendon se ka qenë në ofertë ka qenë diçka tjetër. Deklarata nën betim ka qenë e fotokopjuar dhe OE Limit ka dhënë arsyetim pse nuk ka mund me kohë të siguroj me kohë deklaratën nga Boja.

OE" Limit" thotë se "OE BOJA nga Serbja nuk ka deshtë me ja nënshkrua deklaratën nën betim ngase në dokumentacion është cekur Republika e Kosovës". Unë them se ka bërë marrëveshje të falsifikuar me një OE që as nuk njeh shtetin ku jetojmë dhe punojmë. Me që u pranuar ankesa nga OSHP dhe filloj ekspertiza edhe njëherë e lëndës, unë në gjitha pikat jam pajtuar me vlerësimit të ekspertit. Menaxheri projekti është pronar i firmës Sinjalizimi dhe me këndë do të bëjë kontratë pune. Nga kozorciumi dy palësh është caktuar si menaxher i projektit mirëpo thotë se nuk ka kontratë pune , me këndë duhet të ketë kontratë ky person. Nëse menaxheri merret nga jashtë atëherë do duhej kontratë bashkëpunimi. Qarkullimi plotësojnë njëri tjetrin në mënyrë shumë adekuate, dhe të përthyera dokumentet në gjuhë angleze. Tek sinjalizuesi tek loto.2, te kërkesat për pajisje kemi kërkuar një shënjues, ndërsa OE ankues thotë pse nuk ka kamionët e regjistruar, ndërsa ne nuk kemi pas asnjë kërkesë për kamion, ndërsa shenjëzuesit nuk regjistrohen me librezë qarkullimi, dhe si bartë OE pajisjen është çështje tyre. Tek tabelat është kërkuar që të ofrohen tabele në përputhje me udhëzuesin për shenjëzim të rrugësve, dhe lidhur me këtë nuk qëndron asnjë nga pretendimet e OE ankues".

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Basha i cili deklaroj: "Pretendimet e OE ankues lidhur me mos plotësimin e kritereve teknike profesionale dhe gjendjes ekonomike të OE të rekomanduar për kontratë, janë të paqëndrueshme për faktin se siç kam cek në ekspertizë vetëm OE:"ZMASI" i plotëson kërkesat lidhur me qarkullin bankarë dhe lidhur me kontratat dhe referencat. Propozimi im për hedhje të ankesës si të palejuar të OE" Limit"bazohet në faktin se është i papërgjegjshëm në raportin e parë të ekspertizës dhe vendim të panelit shqyrtues të OSHP.

OE i rekomanduar për kontratë ZMAS është i vetmi që mbulon qarkullimin bankarë sipas viteve të kërkuara nga AK.

Paneli shqyrtues nga shkresat e lëndës gjeti se nuk qëndron pretendimi i OE ankues se ka ofruar marrëveshje të konzorciumit me OE "Boja" dhe "Drini kompani"sepse në FDT i njëjti ka ofertuar me konzorcium dhe është e shënuar grupi i OE,ndërsa ka ofruar marrëveshje të nën kontraktimit ku nën kontraktor kanë qenë OE"Boja" dhe "Drini Kompani",OE ankues nga shkresat e lëndës ka dorëzuar marrëveshje të nën kontraktimi e cila nuk e plotëson marrëveshjen e themelimit të grupit të OE ashtu si kërkohet me dispozitat e nenit 71 të LPP-ës për këtë çështje paneli shqyrtues ka vendosur me vendimin nr.435/16 dt.17.01.2017.

Paneli shqyrtues me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me pretendimet e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar specifikimet teknike lidhur me gjatësinë dhe gjerësinë e tabelave sepse në DT është kërkuar dimensioni prej **25 cm** gjerësia ndërsa i njëjti OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me **24.7 cm**,për këtë paneli shqyrtues ka ftuar ekspertin teknik me dt.31.03.2016 për të sqaruar dhe vërtetuar këtë pretendim ankimor në prezencë të ekspertit shqyrtues dhe procesmbajtësit u faktua se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me tabelë e cila gjerësia e saj është **24.9cm** e jo **25cm** ashtu siq është kërkuar në DT, andaj për panelin shqyrtues qëndron ky pretendim sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar minimumin e kërkesave të AK lidhur me gjerësinë e tabelave, sipas gjetjeve të ekspertit teknik.

Lidhur me këtë paneli shqyrtues në pajtim me nenin 100,101 dhe 102 të Ligjit për Procedurë Administrative nr.02/L-28 e shfuqizon vendimin e panelit shqyrtues nr. nr. 435/16 i dt.17.01.2017 sepse nuk është përbush kriteri i kërkuar në DT dhe për këtë fakt paneli shqyrtues nuk ka qenë i njoftuar me rastin e vendim marrjes.

Nuk qëndron pretendimi se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 50 të LPP-ës sepse kriter i dhënies së kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm çmimi më i ulët, ku OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat e nenit 71 të LPP-ës duke konkurruar me grupin e OE ndërsa nuk ka dorëzuar marrëveshjet me OE "Boja"dhe "Drini Company",AK ka vepruar po ashtu në pajtim me nenin 59 të LPP-ës me rastin e vlerësimit të ofertave sepse i njëjti nuk ka qenë i përgjegjshëm sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe atë: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues dhe konstatimet nga gjeti se AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 28 të LPP-ës.

Andaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Tefik Sylejmani
_____

REPUBLIKA E KOSOVËS
PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT
PRISHTINË
ZA RAZMATRANJE NABAVKI
REPUBLIKA KOSOVA